



VENDIM

Nr. 83, Datë 30.06.2015

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “GAMA ENERGY” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC-et “LENA 1” ME FUQI TË INSTALUAR 1.95 MW, “LENA 2” ME
FUQI TË INSTALUAR 2.3 MW DHE “LENA 2A”; ME FUQI TË
INSTALUAR 0.25 MW, (ME FUQI TOTALE 4.5 MW)**

Në mbështetje të neneve 2 gërma “c”; 16; 37 pika 2 gërma “a” dhe 39 pika 3 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1, gërma “a”; dhe 13 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.06.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GAMA ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec-et ”Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licensës (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “GAMA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: “Lena 1” me fuqi të instaluar 1.95 MW; “Lena 2” me fuqi të instaluar 2.3 MW dhe “Lena 2A” me fuqi të instaluar 0.25 MW, (me fuqi totale 4.5 MW), për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI